

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nëse opozita dhe politika do të kishte gjuhën e Alimehmetit... - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/nese-opozita-dhe-politika-do-te-kishte-gjuhen-e-alimehmetit
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 20:21:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 19:59:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fc03d7dd59a0aa41abdf168dacc25bdc44f06f222d1a491e901d49eb616f272
TEKSTI	4ef495b519b1457af938e94d953632ebc670b1069626d21bc4ef8572674001da
PAMJA	a2e8b0591b3f52fb49b4351c622c4a71f803cbd889f64c0691f95b04b2a5068f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7f4bc2f67631c38dfc4c1a8cde5e52f2552d193919e73e6363b6171f471eafce
E MËPARSHMJA	951f3a6226eae03a2cb22b20be9607d3886c8bd229fcd6a6f3cb1213d04e5b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7f4bc2f67631c38dfc4c1a8cde5e52f2552d193919e73e6363b6171f471eafce>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Integrimi/ Berisha: Janë vendosur një breshëri kushtesh! Me projektin e Portit të Durrësit vidhen miliarda dollarë



Opinion

Periferi

Nëse opozita dhe politika do të kishte gjuhën e Alimehmetit...

Është fare e thjeshtë të shohim se ç'prodhoi në këto vite retorika e dhunës e disa politikanëve edhe tek njerëz të thjeshtë apo tek elita kulturore shqiptare



Ilir Alimehmeti



Alba Malltezi

8 Shtator, 21:51 | Përditësimi: 9 Shtator, 09:09

f Share Tweet



A A

Mund të jesh apo jo dakord me doktor Ilir Alimehmetin, si opozitar, por ai dëgjohej dhe ka një logjikë i gjithë diskursi i tij sa herë flet në publik. Është ndër ata politikanë të opozitës shqiptare që të lejon ta ndjekësh nga fillimi në fund. Ndër të paktët politikanë, që nuk të bën të fikësh televizorin. Ishte kështu dhe sot i ftuar në Report TV: I qartë, i qetë, i informuar, kundërshtar i mazhorancës. Qytetar!

Si do të kishte qenë tranzicioni ynë i gjatë e i lodhshëm nëse politikanë si [Ilir Alimehmeti](#) do të përbënin shumicën dhe jo pakicën siç ndodh sot? A do të ishim mësuar të gjithë të dëgjonim, pastaj të flisnim? Të informohemi dhe pastaj të kundërshtojmë? Të respektojmë çdo mendim ndryshe? Të pranojmë çdo realitet të ndryshëm nga i yni dhe nëse dimë të bëjmë më të mirën, ta përmirësojmë?

Si do të ishte dhe vetë Partia Demokratike dhe opozita, e cila po kalon një kalvar torturash dhe autotorturash, copëtimesh, deligitimimesh, nëse shumica e politikanëve të saj, në vend të ulërimeve, dhunës, shpifjeve, sharjeve, sajimeve, të vërtetave dhe gjysëm të vërtetave, do të përpiqej t'i ngjasonte sadopak Ilir Alimehmetit në diksurset e tij në publik, apo atyre të tjerëve politikanëve të paktë që si ai janë?

[Sh]
.com



LEXO EDHE:

Hamdi Jupe: Leximi i numrave ose, mjerim opozitar!

Është e thjeshtë të shohim çfarë ka prodhuar retorika agresive e një pjesë të madhe të politikanëve shqiptarë; Pasqyrën e veprave të tyre e shohim te disa të rinj e të reja në bulevard që përdorin të njëjtën gjuhë, të njëjtat forma, të njëjtat shpifje, të njëjtat çjerrije. Të painformuar dhe me kokën të mbushur plot me fake news të marra nga politikanë apo të thëna nëpër studio televizive.

Është fare e thjeshtë të shohim se ç'prodhoi në këto vite retorika e dhunës e disa politikanëve edhe tek njerëz të thjeshtë apo tek elita kulturore shqiptare: Lehtësinë e agresivitetit ekstrem të fjalës, edhe pa ditur gjë fare. Vetëm instikte, vetëm xheloz, vetëm dhunë, vetëm agresivitet. Vetëm plasje, shpërthime, bomba... edhe për më të voglin provokim.

Edhe për gazetarët në redaksi është e vështirë që një politikan i logjikës dhe i qetë si Alimehmeti të prodhojë Lajm. Në fakt, pas shpërthimeve dhe ulërimeve të disa politikanëve të tjerë, protestuesve që zënë pritë nëpër qendra komerciale me celular në dorë dhe fjalën e fundit në gjuhë... doktor Alimehmeti i erdhi radha të publikohej në orët e vona të natës online... Nuk kishte "shpërthyer", nuk "plasi bombën", "nuk u tall me dikë", "nuk shpifi për një tjetër"... Pra: Nuk do të ishte i pëlqyeshëm për të shumtët dhe algoritmin që i përgjigjet instikteve.

Nëse sot kemi pak politikanë si Ilir Alimehmeti, duhet të mendojmë se sa vëmendja jonë, sa interesi ynë ushqen dhe konsumon politikanë agresivë. Realiteti i tranzicionit tonë të lodhshëm dhe të gjatë, është pasqyra e asaj që ne dëshirojmë dhe projektojmë.

a.m./S.I.E./Shqiptarja.com

TAG: [ilir alimehmeti](#) [alba malltezi](#) [PD](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull?  4.4 / 5 (43 vlerësime)

OPINIONET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

16 Shtator, 14:18

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Armijtë imagjinarë dhe shënjestra e prishur e opozitës



Vilant Xhori

20 Shtator, 14:13



Vrasja në Sarandë/ Zhupa: 4 ngjarje të rënda në sagën e hakmarrjeve që e di gjithë qyteti, policia të reformohet

20 Shtator, 13:31



Tabaku: Familjet shqiptare mbyllin muajin me borxh, ndërsa korrupsioni rëndon koston e jetesës (VIDEO)

19 Shtator, 15:24



Berisha: Në SHBA denoncuam aferat e Ramës! Nuk lloboj për t'ia ndaluar vizën në Amerikë, por jam i motivuar ta largoj

19 Shtator, 15:02



14 shtatori '98/ Ish-drejtuari i lartë i Policisë: Sherrin e mbolli Sali komunisti! Berisha përdori vdekjen e Azem Hajdarit për luftë politike kriminale, në varrim morën pjesë vetëm 99 vetë

18 Shtator, 21:40



PD propozon 3 pr/ligje për kontrollin e fondeve: Duhet gjurmim i parave publike që i përdor privati, të krijohet regjistri elektronik për financimet dhe pasuritë shtetërore



Eliza Gjedik

18 Shtator, 15:46



'Sot thoni dokrra në Kuvend'/ Spaho 'rrëzon' opozitën: Mbështetët krijimin e Gjykatës Speciale! Berisha votoi pro ngritjes së komisionit të Dick Marty



Edmond Spaho

18 Shtator, 09:13

Tenderi për hemodializën, PD ngre dyshime për mungesë konkurrence! Spahiu: Presim auditimin! Në 2027-ën sjell PET Scan-in, ose jap dorëheqjen



Joana Preja

17 Shtator, 13:29

Rrëzohet kërkesa e PD për komision hetimor për 'KAYO', Bardhi: Ka shpenzuar 34 mln € euro! Balla: Nuk plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore

17 Shtator, 09:34



Kuvend/ Pagat e magjistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Bardhi: Puç kushtetues, votojmë kundër! Malaj: Si u kërcënuan punonjësit e Thesarit nga prokurori

17 Shtator, 07:57



Ylli Pata: Drejtësia, si flamur i flamingove?



Ylli Pata

15 Shtator, 21:03



Llalla në 'Albania NewsCast': 80% e PD-së komandohet nga Greqia, PS ka vepruar më me diplomaci

15 Shtator, 15:24

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptaria.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptaria.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.